



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 11 QERSHOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 11.
JUNA 2008. GODINE

QERSHOR – JUNI

2008

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i Himnit shtetëror të Republikës së Kosovës.

D n e v n i r e d:

1. Usvajanje državne himne Republike Kosova.

A g e n d a:

1. Approval of the state anthem of the Republic of Kosovo.

Seanca plenare filloi punën në orën 11,00.

Seancën plenare e kryesoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuari President Sejdiu,

I nderuari Kryeministër Thaçi,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 98 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se seanca e sotme plenare është thirrur me kërkesën e Presidentit dhe të Kryeministrit të Kosovës, me të vetmen pikë të rendit të ditës:

- Miratimi i Himnit shtetëror të Republikës së Kosovës

Më 12 mars të vitit 2008, në të përditshmet tona është shpallur konkursi për Himnin e Republikës së Kosovës.

Kriteret që duhej t'i plotësonin ofertuesit e Himnit të ri të Republikës së Kosovës, ishin:

1. Kompozimi duhet të jetë i dallueshëm, unik dhe origjinal,
2. Kompozimi nuk duhet të jetë më i shkurtër se 30 sekonda dhe më i gjatë se 60 sekonda,
3. Propozimet duhet t'i përmbahen frymës së Dokumentit gjithëpërfshirës për statusin politik të Kosovës, dhe
4. Nuk duhet të përngjajë me asnjë himn ose këngë popullore të asnjë vendi tjetër.

Konform këtyre propozimeve, Komisionit për përzgjedhjen e Himnit, i kanë arritur 134 propozime – 110 nga Kosova dhe 24 nga vende të tjera. Një ishte nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 7 nga Franca, 2 nga Gjermania, 1 nga Holanda, 5 nga Shqipëria, 2 nga Sllovenia, 1 nga Zelanda e Re, 2 nga Suedia, 1 nga Rusia, 1 nga Britania e Madhe dhe 1 nga Kroacia.

Komisioni për përzgjedhjen e Himnit kishte përbërje politike dhe profesionale dhe ishte në këtë përbërje:

- Hajredin Kuçi, kryetar,
- Nekibe Kelmendi, nënkryetare,
- Arsim Bajrami, Ramë Manaj, Mahir Yagcillar, Fadil Ferati, Bujar Dugolli, Esat Brajshori, Berim Ramosaj, anëtarë,

- Ilir Bajri dhe Baki Jashari, profesionistë, dhe
- Anëtari i 12, nga komuniteti serb, ishte Slobodan Petroviq.

Komisioni ka përzgjedhur 3 propozime:

- Numrin 80, me kodin “Evropa”, të radhitur në vendin e parë;
- Numrin 28, pa kod, të radhitur në vendin e dytë, dhe
- Numrin 07, me kodin 2751, në vendin e tretë.

Më 4 qershor të vitit 2008, me kërkesën e Presidentit dhe të Kryeministrit është mbajtur një mbledhje me Kryetarin e Parlamentit, Kryesinë e Parlamentit dhe kryetarët e grupeve parlamentare dhe janë prezantuar rezultatet e konkursit.

Në atë mbledhje janë prezantuar rezultatet e Komisionit për Himnin e Republikës së Kosovës. Aty është marrë vendimi që rezultatet e konkursit të përzgjedhur nga Komisioni për Himnin, t’iu prezantohen grupeve parlamentare të Kuvendit dhe të përcaktohen për njërin nga variantet e propozuara.

Përcaktimi i shumicës ishte për variantin e parë, me kodin “Evropa”.

Sot, të nderuar deputetë, është nder për të gjithë që arritëm ta shpallim Deklaratën e Pavarësisë për Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, pastaj kemi miratuar Flamurin dhe simbolin e shtetit të Kosovës – Kushtetutën e Kosovës dhe sot, me miratimin e Himnit të Kosovës, po i rrumbullakojmë simbolet e Republikës së Kosovës, shtet të pavarur dhe sovran.

Po ashtu, me rrumbullakimin e ligjeve që dalin nga Pakoja gjithëpërfshirëse për statusin politik të Kosovës, ne po përgatitemi që, pas 15 qershorit 2008, institucionet e Kosovës t’i marrin të gjitha përgjegjësitë që i kanë me Kushtetutën e re të Republikës së Kosovës.

Në këtë moment, kërkoj nga regjia që të gjithë së bashku ta dëgjojmë Himnin dhe pastaj të kalojmë në procedurën e votimit.

(Bëhet interpretimi i Himnit – me numrin 80 – “Evropa”)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Dëgjuat propozimin për Himnin e Kosovës.

Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare të deklarohen.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që të prezantojë qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotin Ramë Buja.

Ju njoftoj se tani në sallë janë të pranishëm 102 deputetë.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar i Kuvendit,

Zoti Kryeministër,

Zoti President, më falni,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi që ne, si Grup Parlamentar, dëgjuam 3 versionet e Himnit, nuk patëm asnjë dilemë rreth kësaj dhe u pajtuam që votën tonë ta japim për Himnin numër 1, me kodin “Evropa”. Andaj – urime!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti President,

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, po ashtu ka dëgjuar 3 propozimet. Ne kemi debatuar edhe atë ditë, edhe sot në mëngjes. Sigurisht se angazhimi ynë ka qenë në mbështetje me konsensus të punës së Komisionit dhe për përzgjedhjen më të mirë. Nga këto propozime, Grupi Parlamentar i LDK-së, mbështet propozimin e parë me shifrën “Evropa”. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tani radha është për Grupin Parlamentar të AKR-së. Fjalën e ka kryetari i Partisë dhe deputeti Behgjet Pacolli.

BEHGJET PACOLLI: I nderuari, zoti President!

Zoti Kryeministër,

Zoti Kryetar i Parlamentit të Kosovës,

Kolegë, ministra,

Grupi Parlamentar i AKR-së ka hezitime për procedurat me të cilat është kryer zgjedhja e Himnit “Evropa”. Unë personalisht Himnin gati e kam mësuar, sepse e kam dëgjuar disa herë. Prandaj, ia lë vullnetit të deputetëve të Grupit Parlamentar të AKR-së ta votojnë. Unë personalisht e mbështes Himnin “Evropa”, e votoj dhe besoj se edhe deputetët e AKR-së do ta bëjnë të njëjtën gjë. Na qoftë për hair Himni i Kosovës! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shefi i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet propozimin e parë, të cilin e dëgjuam. Ne kërkojmë vetëm të jetë një sqarim i duhur edhe për transkripto, edhe për publikun se Himni quhet: “Himni i Republikës së Kosovës” dhe “Evropa” është vetëm kod dhe nuk ka nevojë të përmendet. Do të thotë, është Himn i Republikës së Kosovës, kurse kodi s’ka nevojë të përmendet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për sqarim! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kryetari i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, në fakt, nuk është i kënaqur me hapësirën e përzgjedhjes së këtyre alternativave deri më tash të ofruara. Mirëpo, duke

pasur në konsideratë krejt procedurën e zhvillimit të këtij procesi, normalisht, si Grup Parlamentar ne do të marrim pjesë në proces të votimit dhe secili deputet do ta ketë të drejtën e vet të votës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha, e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti President i Republikës së Kosovës,

Zoti Kryeministër i Republikës së Kosovës,

Zotëri zëvendëskryeministra, ministra,

Zoja e zotërinj deputetë,

Sot para nesh është duke u kryer një punë, të cilin e kemi pritur shumë kohë. Prej 3 propozimeve që i kemi zgjedhur, më e mira ka qenë kjo e “Evropës” dhe sikur që tha kryetari – për hair na qoftë të gjithëve. S’kemi më të mirë tash për tash. Më tutje, të shohim! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të SLS-së, mungon.

Tani do të votojmë.

Ftoj deputetët që, me ngritjen e dorës, të deklarohen për propozimin e Himnit që posa e dëgjuam.

Lus regjinë, le ta bëjë numërimin e votave.

Kush është për këtë propozim?

Kush është kundër?

A ka kush që abstenon?

Konstatoj se me 72 vota “për”, 15 “kundër” dhe 5 abstenime – Kuvendi i Kosovës miratoi Himnin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Ftoj deputetët që të ngrihen në këmbë dhe ta nderojmë Himnin e sapo miratuar.

(Të pranishmit në sallë, të ngritur në këmbë, e dëgjojnë Himnin e Republikës së Kosovës)

(Duartrokitje)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, qytetarë të Kosovës: Urime Himni i shtetit - Republikës së Kosovës. Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Seancën e shpall të mbyllur!

Përgatiti: **Njësia e Transkripteve**